

VENDIM
Nr. 139, datë 6.6.2022

MBI REFUZIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “NTSP” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2000 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 13 dhe nenit 14, pika 2 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 866/6 prot., datë 2.6.2022, “Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë ‘NTSP’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2000 kw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 86, datë 20.4.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NTSP” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. ERE, me shkresën nr. 70/14 prot., datë 22.4.2022, bëri njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 10.5.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla. ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 452/1 prot., datë 27.4.2022, për njoftimin e vendimit dhe kërkesën për plotësim dokumentacioni. Shoqëria “NTSP” sh.p.k. nuk ka përcjellë asnjë përgjigje/shkresë për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe lejet nga institucionet respektive.

- Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin, si vijon:
- formati dhe dokumentacioni për aplikim – neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2, germa “g”;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, gjerat “a” dhe “d”;
- dokumentacioni teknik për centralin fotovoltaik – neni 9, pika 4.4.2, pika 4.4.3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d” dhe pika 4.4.4, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”;

- leje nga institucione të tjera – neni 9, pika 4.4.5, gjerat “a” dhe “b”.

Sa rezulton nga ky aplikim, mbetet ende pa plotësuar dokumentacioni, si vijon:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- gjerat “a”/”b” (akti i themelimit/statuti).

Shoqëria nuk ka depozituar aktin e themelimit të saj.

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa “c” (Vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB); shoqëria nuk ka përcjellë në ERE Certifikatën e Regjistrimit pranë QKB-së, si dhe Ekstraktin Historik të QKB-së, me datë të përditësuar, sipas kërkesave të nenit 8, pika 3 të rregullores.

- germa “d” (Vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë); shoqëria nuk ka depozituar në ERE vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë të qarkut Korçë për administratorin dhe vetë shoqërinë “NTSP” sh.p.k.

- germa “e” (Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse. Në rastin e aplikimeve për licencë prodhimi të energjisë elektrike kërkohet paraqitja e licencës për drejtues teknik elektrik). Shoqëria nuk ka depozituar në ERE strukturën organizative aktuale të saj.

- germa “f” (Marrëveshje koncesioni apo çdo forme tjetër e marrëveshjes në rastet e aplikueshme të lidhur me institucionet përgjegjëse të ngarkuara me ligj, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës, si dhe ndryshim të këtyre akteve). Shoqëria nuk ka përcjellë në ERE dokumentacionin përkatës (marrëveshjen/kontratën përkatëse me MIE-n), në vijim të miratimit të MIE-s nr. 883/4 prot., datë 11.3.2022.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

- germa “b” (Bilanci financiar i tre vjetëve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë, për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit).

Shoqëria nuk ka depozituar në ERE pasqyrat financiare të vitit 2021:

- germa “c” (Dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe strukturë e financimit, financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera etj.). Dokumenti i depozituar nga shoqëria, në kuadër të shprehjes së interesit, nga banka gati përpara një viti, nuk është përcjellë në kuptim të rregullores me datë të rifreskuar dhe nuk është bërë me dije nëse është nënshkruar me bankën kontratë për të siguruar 80% të investimit dhe as se si do të mbulojë 20% të vlerës së investimit.

Dokumentacioni tekniko-ekonomik, neni 9, pika 4.4.1:

- (Të dhëna teknike për centralin fotovoltaik). Shoqëria nuk ka plotësuar të dhënat për centralin prodhues, emrin e centralit dhe vendndodhjen, sipas kërkesave të formatit përkatës. Po ashtu, shoqëria ka vendosur si vit të operimit vitin 2021 dhe në lidhje me datën e fillimit ka deklaruar se testet janë bërë në janar të vitit 2022, ndërkohë që aplikimi në ERE është paraqitur në prill të vitit 2022, ndaj do t'i kërkohet shoqërisë informacion, në lidhje me statusin e punimeve për ndërtimin e centralit. Gjithashtu është konstatuar një mosrakordim i numrit të njësive gjeneruese dhe i kapacitetit të secilës, nga të dhënat që ka përcjellë shoqëria rezulton se 15 njësi x 175 kw është e barabartë me 2625 kw, çka kalon edhe kufirin +10% të kapacitetit prej 2000 kw, për të cilin kërkohet të licencohet. Shoqërisë i është kërkuar të bëjë një përcaktim të qartë të viteve brenda të cilëve do të ndërtohet projekti, referuar grafikut të zbatimit të punimeve të depozituar nga ana e saj. Në lidhje me dokumentacionin pronësor (kontratën e qirasë), të depozituar nga ana e shoqërisë për territorin ku do të shtrihet projekti, asaj i është kërkuar informacion, nëse këto kontrata janë regjistruar në zyrat përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, sikurse është përcaktuar në vetë dispozitat e këtyre kontratave. Duke qenë se nga dokumentacioni pronësor që subjekti ka depozituar në kuadër të licencimit, rezulton se numri i pasurisë së zonës ku do të shtrihet projekti është i ndryshëm nga ai i pasqyruar në VNM-në paraprake, i është kërkuar shoqërisë që të bëjë saktësimin përkatës. Duke qenë se në aplikimin e shoqërisë “NTSP” sh.p.k. mungon një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit, si dhe nisur nga fakti që kjo shoqëri nuk ka përcjellë asnjë shkresë për plotësim dokumentacioni apo kërkesë për shtyrje të kësaj procedure, vlerësohet të refuzohet kërkesa e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë “NTSP” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2000 kw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti